



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 106/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Adnan Konushevc kryesues, Gyltene Sylejmani dhe Nenad Lazic anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtares së lartë ligjore Antigona Murati, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), Dega në Gjakovë, paraqitur kundër subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), për shkak të vendosjes së posterit në shtylla elektrike, për Zgjedhjet Lokale që do të mbahen më 22.10. 2017, në seancën e panelit të mbajtur me datë 03.10.2017, mori këtë:

VENDIM

KONSTATOHET tërheqja e ankesës e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), ZL. A.nr. 106/2017 të datës 01.10.2017.

Arsyetim

Subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV) ka paraqitur ankesë në PZAP kundër subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), për shkak të vendosjes së posterit të Kandidatit për Kryetar të Komunës së Gjakovës nga radhët e subjektit politik AAK, në Rrugën “Tirana” në Gjakovë, nëpër shtylla të ndriçimit elektrik, për Zgjedhjet Lokale që do të mbahen më 22 tetor 2017.

Me datë 02.10.2017, ankuesi ka parashtruar kërkesë për tërheqjen e ankesës me numër: Anr.106/2017 të datës 01.10.2017.

PZAP-i, pasi që shqyrtoi kërkesën për tërheqjen e ankesës të ankuesit, në kuptim të nenit 115.1 të LZP -së, PZAP -i vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Anr.106/2017 më datën 03.10.2017.

